



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:091179
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05388768

A.nr.778/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditësit N.. A..nga G., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I..N.. avokat nga P.,kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë- Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit, për shkak të anulimit të vendimit nr.12-1181 të datës 22.02.2023 dhe kërkesës për kompenzimin e dëmit, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 28.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit N.. A..nga G., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I..N. avokat nga P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.12-1181 i datës 22.02.2023 i Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me praninë e palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 18.04.2023 ka kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit e ushtruar kundër vendimit të të paditurit. I propozon Gjykatës që padinë ta aprovoj si të bazuar dhe të anulohet vendimin e goditur me padi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësit deklaroi: *“Qëndrojmë në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së sajë, e kundërshtojmë përgjigjen në padi të të paditurës sepse vendimi i të njëjtës konsiderojmë se është i kundërligjshëm për faktin se dëmet që u janë shkaktuar paditësit përmes veprës penale ka arritur parashkrimin absolut të ndjekjes penale dhe me këtë*

fakt në bazë të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i njëjti i plotëson kushtet për kompensim sipas dispozitave të cituara në padi, kurse sa i përket arsyetimit të vendimit se kategoria e veprës penale të kryer ndaj paditësit nuk hynë në kategoritë e veprave penale sipas nenit 6 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nuk qëndron për shkak se paragrafi 2 i këtij neni ka lejuar që edhe veprat tjera në mënyrë të përgjithësuar mund të arsyetojnë kompensimin. Gjykatës i propozojmë që vendimi i të paditurës të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje. Nuk kemi propozime për prova tjera”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare, deklaroi: “Në tërësi si në referatin e kërkesëpadi së dhe deklarimit në seancën e sotme , duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadi si në petitumin e padisë”.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 09.06.2023 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke pohuar se Komisioni vlerëson se viktimi nga vepra penale keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare nuk ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe si i tillë nuk mund të përfitoj në kompensim nga Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kjo pasi që vepra penale për të cilën kërkohet kompensimi nuk hyn në kategorinë e veprave të dhunshme të kompensueshme ashtu siç është përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji. E njëjta Gjykatës i propozon që padinë ta refuzoj si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi me numër protokoll nr.12/1181 dt.22.02.2023, Aktgjykimi i kësaj gjykate nën shenjën P.nr.105/20 dt.23.11.2021, Aktakuza nën shenjën PP/II Nr.4000/16 dt.16.01.2020, formulari i kërkesës për kompensim i dt.12.12.2022, procesverbali i komisionit përkatës i dt. 22.02.2023, raportet mjekësore dt. 19.07.2021, 27.09.2021, 07.12.2015, 17.05.2021, 23.12.2020, 22.12.2020, 13.06.2021, 08.07.2021, 19.10.2020, 02.03.2020, 28.06.2021, 14.07.2021, 11.06.2021, 14.06.2021, 05.07.2021,14.12.2020, 23.06.2021, 17.11.2015, 16.09.2019, 15.11.2020, 06.02.2020, 02.03.2020, 09.09.2019, 21.12.2020, 19.11.2015, 14.07.2021, ekspertiza mjekoligjore e nxjerrë me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dt. 17.11.2016, kërkesa e dt.15.11.2022, komunikimet elektronike të dt.22.11.2022, dhe 21.11.2022, përgjigje nga Ministria e Drejtësisë dt.21.11.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadi a e paditësit është e pabazuar.

Gjykata vërtetoi të gjitha gjetjet e të paditurës të paraqitura në vendimin e kontestuar me padi sipas së cilave konstatohet se në këtë rast ndaj paditësit është kryer vepra penale e keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike dhe se nuk ka asnjë dëshmi me të cilën do të dëshmohej se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se sipas ekspertizës mjekësore me numër refence PP.II.nr.4000/16 të datës 17.11.2019, eksperti mjeko-ligjor Ass. Dr.A..G.ka konstatuar se natyra e dëmtimeve të tilla në bazë të dokumentacionit prezent kuaifikohet si dëmtim i lehtë trupor. Nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata konstatoi se me faktin që paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, nuk janë konsumuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.08/L-109 për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata poashtu konstatoi se kompensimi si viktimë e krimit në këtë rast, mbi bazën e dëmshpërblimit për shkak të parashkrimit, poashtu nuk është i mundur për faktin që vepra penale e parashkruar duhet të bëj pjesë në grupin e veprave penale nga neni 6 i këtij Ligji.

Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e të paditurit është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Gjykata gjeti se e paditura me vendimin e saj, ligjshëm ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga ana e paditësit dhe në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike.

Gjykata erdhi në përfundim se vendimi i kontestuar i të paditurës në mënyrë të qartë ka përshkruar dhe vlerësuar veçanërisht aspektin formal e procedural që është zhvilluar përgjatë gjithë trajtimit të çështjes administrative të paditësit. Mbi këtë pikëpamje, gjykata i vërtetoi si të drejta dhe të ligjshme të gjitha qëndrimet e organit të paditur.

Andaj duke u bazuar në këto prova, në dispozitat e sipërcituara si dhe në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 17.11.2016, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njejtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njejtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj gjykata vlerësoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësja. Mbi këto arsye thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.778/2023, datë: 28.02.2024

G j y q t a r i

Numri i lëndës: 2023:091179
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05388768

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.